



AGJENCIA E OFRIMIT TE SHËRBIMEVE
PUBLIKE TE INTEGRUARA
AGENCY FOR THE DELIVERY OF
INTEGRATED SERVICES ALBANIA

Nr. 1033, datë 24.10.2017

Nr. 1050, datë 24.10.2017

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

LIDHUR NDËRMJET

PALËVE

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi (në vijim **KMD**), me seli në adresën: Rruga “Sami Frashëri”, Nr. 10, Kati II, Tiranë, është një person juridik publik, që është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 10/2010, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen Nga Diskriminimi”, përfaqësuar nga **Komisioneri Znj. Irma BARAKU**,

DHE

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (në vijim **ADISA**), me seli në adresën: Bulevardi “Zhan D’Ark”, ish Hoteli i Oficerëve, Kati i 6-të, Tiranë, i cili është një person juridik publik, që është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 13, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, përfaqësuar nga **Drejtori Ekzekutiv Znj. Anisa GJIKÀ**.

Palët, së bashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si “**Marrëveshja**”), si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

- 1.1 Në Marrëveshje midis tyre, palët kanë bien dakord që brenda ambienteve të *Zyrës Rajonale Gjirokastrër* (në vijim *Zyra*), e cila administrohet nga ADISA, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi do t’i vihet në dispozicion 1 (një) post pune i dedikuar për ofrimin e shërbimeve të tij. Këto shërbime ofrohen nga Komisioneri për Mbrojtjen nga

Diskriminimi, i cili është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Neni 2

Baza Ligjore

- 2.1 Ligji Nr. 13, datë 18.02.2016 “Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, Ligji Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Neni 119 dhe 121 i Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar), dhe nenet 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë (i ndryshuar).

Neni 3

Afati i Marrëveshjes

- 3.1 Afati i kësaj Marrëveshje është 6 (gjashtë)muaj me të drejtë rinovimi dhe fillon nga data e nënshkrimit të saj nga palët.
- 3.2 Afati i përcaktuar më sipër mund të ndryshohet përmes një marrëveshje me shkrim midis palëve

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi

- 4.1 Me nënshkrimin e kësaj marrëveshje Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi merr përsipër të transferojë një sportel të shërbimit, nga ambientet ku është i vendosur aktualisht, në ambientet e Zyrës Rajonale Gjirokastër të vëna në dispozicion nga ADISA pa kundërshtim.
- 4.2 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi merr përsipër sigurimin e të gjitha pajisjeve të nevojshme IT (kompjuter, printer, skaner, fotokopje etj.), duke siguruar kushte normale pune.
- 4.3 Të bëjë të mundur funksionimin e sistemit të KMD, të nevojshëm për ofrimin e shërbimeve të saj në sportelet e Zyrës Rajonale Gjirokastër.
- 4.4 Të vërë në dispozicion punonjësin e ngarkuar prej saj për ofrimin e shërbimeve në sportel, i cili duhet të respektojë tërësinë e rregullave për etikën e sjelljes, komunikimit dhe veshjes, sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve në sportel.
- 4.5 Punonjësi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka detyrimin të marrë pjesë në trajnimet që organizohen nga ADISA në kuadër të përmirësimit të shërbimeve publike.
- 4.6 Të pranojë ankesat e qytetarëve në lidhje me cilësinë e shërbimit ndaj tyre, të mbledhura nga punonjësit e ADISA-s pranë QENDRËS dhe që i përcillen me shkrim në fund të çdo

dite. Ankesat duhet të shqyrtohen brenda afateve ligjore dhe në varësi të shkeljes KMD duhet të marrë masat e nevojshme ndaj punonjësit përkatës.

- 4.7 Të ushtrojë të gjitha detyrat të ngarkuara sipas përcaktimeve të ligjit Nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, dhe kuadrin ligjor në fuqi që rregullon veprimtarinë e tij në hapësirën e caktuar, ashtu si janë ushtruar edhe përpara nënshkrimit të kësaj marrëveshje.
- 4.8 Të mirëmbajë të gjitha mobiliet, pajisjet dhe mjetet e tjera të dhëna në përdorim nga ADISA gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes dhe t’i dorëzojë ato në gjendje pune në momentin e përfundimit të Marrëveshjes.
- 4.9 Të kujdeset për mirëmbajtjen e ambienteve të marra në përdorim deri në kthimin e tyre në përfundim të Marrëveshjes.
- 4.10 Të sigurojë bazën materiale të domosdoshme për funksionimin e sportelit dhe ofrimin e shërbimeve.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e ADISA

- 5.1 ADISA merr përsipër që gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes t’i vërë në dispozicion pa kundërshpërblim Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi ambientet për funksionimin e 1 (një) posti pune, të mobiluar (post pune i kompletuar me tavolinë, karrige, raft) duke siguruar kushte normale pune dhe akses nga publiku.
- 5.2 Të trajnojë punonjësën e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi që do të shërbejë në sportel në lidhje me etikën e komunikimit, modelet e sjelljes, menaxhimit të presionit në punë etj., me qëllim edukimin e tij për të ofruar shërbimin në mënyrë sa më të shpejtë dhe cilësore për qytetarin.
- 5.3 Të sigurojë sistemin e menaxhimit të radhës në mënyrë elektronike dhe të përbashkët për të gjitha sportelet e Zyrës Rajonale Gjirokastrë, përfshirë këtu dhe sportelin e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- 5.4 Të sigurojë informacion për publikun nëpërmjet sportelit të informacionit dhe punonjësit përkatës në lidhje me shërbimet e ofruara nga sporteli i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- 5.5 Të mbledhë dhe administrojë ankesat e qytetarëve në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar nga punonjësi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, që shërben në sportel dhe t’ia përcjellë me shkrim këtij të fundit.
- 5.6 Titullari i ADISA-s kërkon zëvendësimin e punonjësit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, nëse ky i fundit nuk kryen detyrën sipas treguesve të cilësisë së ofrimit të shërbimeve në sportel. Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi zëvendëson punonjësën menjëherë në rast mosrespektimi të standardeve të ofrimit të shërbimit në sportel.

- 5.7 Të marrë në dorëzim në përfundim të Marrëveshjes ambientet e dhëna në përdorim, mobiliet dhe pajisjet në gjendjen që i ka dorëzuar, duke konsideruar amortizimin normal të tyre.

Neni 6

Punonjësi i KMD, të drejtat dhe detyrimet e tij

- 6.1 Punonjësi i ngarkuar për ofrimin e shërbimeve në postin e punës të vënë në dispozicion është nëpunës i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i emëruar në bazë të legjislacionit në fuqi.
- 6.2 Marrëdhënia e tij e punës mbetet në fuqi dhe nuk transferohet tek ADISA gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje.
- 6.3 ADISA nuk ka detyrime financiare ndaj punonjësit të KMD-së, i cili shërben në sportelin e vendosur në hapësirat e Zyrës Rajonale Gjirokastrë.

Neni 7

Shpenzimet për funksionimin e sportelit

- 7.1 Shpenzimet për funksionimin e sportelit përballohen nga fondet e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe mbulojnë shpenzimet për pagën, sigurimet shoqërore dhe shëndetësore për punonjësin e sportelit, si dhe shpenzimet operative (bojë për pajisjet, letër, kancelari etj.) për mirëfunksionimin e sportelit të shërbimit.
- 7.2 ADISA merr përsipër të sigurojë vënien në dispozicion të postit të punës brenda ambienteve të Zyrës Rajonale Gjirokastrë sipas nenit 5.1 si dhe furnizimin e ambientit të punës me linjë interneti, energji elektrike dhe ujë të pijshëm.
- 7.3 Pajisjet që jepen në përdorim gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes mbeten në pronësi të ADISA, e cila merr përsipër edhe amortizimin normal të tyre.

Neni 8

Orari i funksionimit të sportelit

- 8.1 Orari i pranimit të aplikimeve për sportel është:
E hënë - E premte ora 08:00 - 14:00.
- 8.2 Orari gjatë të cilit ambientet e ADISA-s mund të përdoren nga punonjësi i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi sipas kësaj Marrëveshje është 08:00-16:30 çdo ditë pune.
- 8.3 Përgjegjësi i sporteleve të Zyrës Rajonale Gjirokastrë do t'i raportojë për paraqitjen e punonjësit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi çdo ditë zyrës së burimeve njerëzore të këtij të fundit.

Neni 9

Shkëmbimi i informacionit dhe i dokumentacionit

- 9.1 Procesi i ofrimit të shërbimit në sportel do të bëhet në bazë të rregullimeve ligjore/nënligjore/kontraktuale në fuqi për ofrimin e shërbimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe Ligjit 13/2016, datë 18.02.2016 “Për ofrimin e shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë”, për aq sa ky i fundit nuk bie në kundërshtim me rregullimet ligjore aktuale për ofrimin e këtyre shërbimeve.
- 9.2 Me kërkesë të ADISA-s, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi i vë në dispozicion kësaj të fundit raporte në lidhje me aplikimet dhe afatet e përgjigjeve për aq sa është e mundur nga legjislacioni në fuqi.
- 9.3 Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vë në dispozicion punonjësit të sportelit të informacionit të ADISA pranë Zyrës Rajonale Gjirokastër materiale informuese të tij, siç broshura dhe informacione të tjera në lidhje me shërbimet përkatëse.

Neni 10

Zgjidhja e Marrëveshjes

- 10.1 Marrëveshja përfundon me përmbushjen e afatit të përcaktuar në nenin 3 të saj.
- 10.2 Marrëveshja mund të zgjidhet nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në rast se nuk janë plotësuar kushtet e nevojshme për ofrimin e shërbimit nga ADISA, si:
 - Vënia në dispozicion e postit të punës;
 - Vënia në dispozicion e mobilieve;
 - Furnizimi me internet.
- 10.3 Marrëveshja mund të zgjidhet nga ADISA në rast se:
 - Punonjësi i KMD nuk respekton tërësinë e rregullave për etikën e sjelljes, komunikimit dhe veshjes, sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve në sportel;
 - KMD nuk siguron bazën materiale dhe pajisjet IT të nevojshme për funksionimin e sporteleve dhe ofrimin e shërbimit.
 - KMD nuk respekton detyrimet e tjera të parashikuara sipas Nenit 4.
- 10.4 Marrëveshja mund të zgjidhet përpara përmbushjes së afatit për shkaqe të arsyeshme me kërkesë të njëjës palë, duke e njoftuar palën tjetër me shkrim, të paktën një muaj përpara.

Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

11.1 Çdo mosmarrëveshje që lind ose mund të lindë nga ose gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje do të zgjidhet me mirëkuptim midis palëve, në rast të kundërt mosmarrëveshja zgjidhet sipas përcaktimeve të Kodit të Procedurave Administrative.

Neni 12
Hyrja në fuqi

12.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 13
Dispozita të fundit

13.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u hartua në 4 (katër) kopje me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe dhe secila palë mban 2 (dy) kopje të njëjta.

PALËT

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN
NGA DISKRIMINIMI**

**AGJENCIA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE
PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)**

Përfaqësuar nga:

Përfaqësuar nga:

KOMISIONERI

DREJTOR EKZEKUTIV

Irma BARAKU

Anisa GJIKU

